



12-00-2021

Prishtinë / Priština

Nr./Br. 1948-2021



Në pajtim me nenin 64.2 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe bazuar në vendimin e datës 14.07.2021, Nr.0433/2021, të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në mbledhjen e mbajtur më datën 12.08.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nxjerr këtë:

## VENDIM

**Për miratimin e rekomandimit për pranimin e dokumenteve të identifikimit letërnjoftimit me afat të skaduar të Republikës së Kosovës, për identifikim në vendvotim ditën e zgjedhjeve dhe në procesin e votimit jashtë Kosovës**

- I. Miratohet rekomandimi i Këshillit për Operacione Zgjedhore, për pranimin e dokumenteve të identifikimit letërnjoftimit me afat të skaduar të Republikës së Kosovës, për identifikim e votuesve në vendvotim ditën e zgjedhjeve dhe procesin e votimit jashtë Kosovës.
- II. Votuesit në ditën e zgjedhjeve në vendvotim identifikohen me dokument të Republikës së Kosovës me afat të skaduar do të pranohen si dokument identifikues dhe ju lejohet votimi.
- III. Aplikuesit që kanë dërguar dhe që do të dërgojnë aplikacione për regjistrim, me kopjet e dokumenteve të identifikimit letërnjoftimin e Republikës së Kosovës me afat të skaduar, por që me kusht nuk kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës, do të aprovohen dhe përfshihen si votues në listën e votuesve jashtë Kosovës.
- IV. Votuesit e aprovuar suksesshëm në periudhën e aplikimit, nëse në fazën e votimit e dërgojnë pakon me fletëvotim, ku brenda kësaj është dërguar edhe kopja e dokumentit identifikues letërnjoftimin me afat të skaduar të Republikës së Kosovës, të ju aprovohet pakoja me fletëvotim.
- V. Ky vendim do të vlejë edhe për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar Komune.
- VI. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- VII. Ky vendim, hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Bazuar në nenin 90 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës, Dokumentet e pranueshme të identifikimi janë si në vijim:

- a) Letërnyoftim i vlefshëm,
- b) Pasaportë valide,
- c) Dokument i vlefshëm i udhëtimit,
- d) Leja e vozitjes e vlefshme e Kosovës.

Ndërsa, sipas nenit 4.2 të Rregullës Zgjedhore Nr. 03/ 2013, për Votimin Jashtë Kosovës, pas plotësimit të fletëvotimit, votuesi duhet të vendosë fletëvotimin në një zarf të pa shënuar e të mbyllur të vendosur brenda zarfit të jashtëm për dërgim. Në zarfin e dërgimit votuesi gjithashtu vendosë një kopje të dokumentit të vlefshëm të identifikimit.

Në kriteret e zotësisë juridike, njëra nga kushtet për t'u përfshirë në listën e votueseve jashtë Kosovës, duhet të dëshmohet identiteti, duke dërguar kopjen e dokumentit të vlefshëm të identifikimi.

Si rezultat i mos prodhimit të dokumenteve të identifikimit letërnyoftimit, Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datën 14.07.2021 ka marrë vendim si në vijim:

“Të gjithë shtetasve të Republikës së Kosovës, pavarësisht afatit të skadimit të vlefshmërisë së letërnyoftimit, letërnyoftimi i tyre konsiderohet i vlefshëm edhe për gjashtë (6) muaj me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, si dhe mund ta përdorin për kryerjen e shërbimeve në institucionet publike dhe private, brenda Republikës së Kosovës”.

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 12.08.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

**Kreshnik Radoniqi**





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Data	12.08.2021	Ref. Nr.
Për	Komisionin Qendror të Zgjedhjeve	
Nga	Këshilli për Operacione Zgjedhore	
Përmes	Burim Ahmetaj, Kryeshef Ekzekutiv i SKQZ-së Besnik Buzhala, U.D. Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv i SKQZ-së	
Lënda	Rekomandim për pranimin e dokumenteve të identifikimit (letërnjoftimeve) me afat të skaduar të Republikës së Kosovës për identifikim në vendvotime dhe në procesin e votimit jashtë Kosovës.	

Bazuar në nenin 90 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës, Dokumentet e pranueshme të identifikimi janë si në vijim:

- a) Letërnjoftim i vlefshëm,
- b) Pasaportë valide,
- c) Dokument i vlefshëm i udhëtimit,
- d) Leja e vozitjes e vlefshme e Kosovës, etj.

Ndërsa, sipas Rregullës Zgjedhore Nr. 03/ 2013 Votimi jashtë Kosovës, neni 4.2: "Pas plotësimi të fletëvotimeve, votuesi duhet të vendosë fletëvotimin në një zarf të pa shënuar e të mbyllur të vendosur brenda zarfit të jashtëm për dërgim. Në zarfin e dërgimit votuesi gjithashtu vendosë një fotokopje të dokumentit të vlefshëm të identifikimit....".

Si rezultat i mos prodhimit të dokumenteve të identifikimit (letërnjoftimeve) Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datën 14.07.2021 ka marrë vendim si në vijim:

"Të gjithë shtetasve të Republikës së Kosovës, pavarësisht afatit të skadimit të vlefshmërisë së letërnjoftimit, letërnjoftimi i tyre konsiderohet i vlefshëm edhe për gjashtë (6) muaj me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, si dhe mund ta përdorin për kryerjen e shërbimeve në institucionet publike dhe private, brenda Republikës së Kosovës<sup>1</sup>".

<sup>1</sup> Vendimi Nr. 0433/ 2021, datë 14.07.2021.

Me qëllim që pranimit të dokumenteve identifikuese (letërnjoftimeve) të lëshuara nga Republika e Kosovës, të cilave iu ka skaduar afati i vlefshmërisë dhe të cilat mund të përdoren për identifikim në vendvotim në ditën e zgjedhjeve dhe me qëllim që dokumentet e identifikimit me afat të skaduar (letërnjoftimeve) të lëshuara nga Republika e Kosovës të cilat dërgohen me qëllim të identifikimit dhe plotësimit të kriterit juridik për tu përfshirë si votues në listën e votuesve jashtë Kosovës, rekomandojmë si në vijim:

1. Votuesit që në ditën e zgjedhjeve, në vendvotim identifikohen me dokument të Republikës së Kosovës me afat të skaduar, të pranohen si dokumente identifikuese dhe të ju lejohet votimi;
2. Aplikuesit që kanë dërguar dhe që do të dërgojnë aplikacione për regjistrim, me kopjet e dokumenteve të identifikimit (letërnjoftimet e Republikës së Kosovës) me afat të skaduar, por që me kusht nuk kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës, të aprovohen dhe përfshihen si votues në listën e votuesve jashtë Kosovës.
3. Votuesit e aprovuar suksesshëm në periudhën e aplikimit, nëse në fazën e votimit e dërgojnë pakon me fletëvotim, ku brenda kësaj është dërguar edhe kopja e dokumentit identifikues (letërnjoftimin) me afat të skaduar të Republikës së Kosovës, të ju aprovohet pakoja me fletëvotim. Kjo të vlejë edhe për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar komune.
4. Rekomandimet vlejnë vetëm për Zgjedhjet Lokale të datës 17 tetor 2021, duke përfshirë edhe raundin e dytë për këtë proces zgjedhor.

Si pjesë e këtij dokumenti, është i bashkangjitur vendimi i Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme (Vendimi Nr. 0433/ 2021, i datës 14.07.2021).